

VENDIM
Nr. 242, datë 12.12.2018

**PËR SHPALLJEN E KANDIDATËVE FITUES PËR ANËTARË GJYQTARË TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Në mbështetje të pikës 7, të nenit 17, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Komisioni i Votimit, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i përbërë nga anëtarët si vijon:

1. Durim Kadiu, kryetar;
2. Engert Pëllumbi, anëtar;
3. Florjan Kalaja, anëtar.

Bazuar në rezultatet e votimit për zgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas procesverbalit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij,

VENDOSI:

1. Të shpallë emrat e kandidatëve fitues për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si vijon:
 - 1) Z. Medi Bici shpallet fitues për Gjykatën e Lartë;
 - 2) Z. Ilir Toska shpallet fitues për Gjykatën e Apelit Tiranë;
 - 3) Znj. Brikena Ukperaj shpallet fitues për Gjykatën e Apelit jashtë Tiranës;
 - 4) Z. Dritan Hallunaj shpallet fitues për Gjykatën e shkallës së parë Tiranë;
 - 5) Znj. Brunilda Kadi shpallet fitues për Gjykatën e shkallës së parë Tiranë;
 - 6) Znj. Marçela Shehu shpallet fitues për Gjykatën e shkallës së parë jashtë Tiranës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 5 (pesë) ditëve, duke nisur ky afat nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe në Fletoren Zyrtare.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I VOTIMIT
Durim Kadiu, Engert Pëllumbi,
Florjan Kalaja